

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Bashkim Ahmeti hap ekspozitën e tij të parë pas shumë kohësh
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/bashkim-ahmeti-hap-ekspoziten-e-tij-te-pare-pas-shume-kohesh-i586607
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 07:36:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 15:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bea14d0c54894a86ad91af54010e5497206a79db5821f61ba23f9da8b8d95a5f
TEKSTI	b89a28fccca638c6f5367a15ab1a615dbb231ef86c920dbeb85adb8b1226cd36
PAMJA	6f63f84190559925bd6be431a1aa4eb33bfe19efc986c804367745d54daa9b71

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5120d4e7bc38b16858648c29687da41fcc92443461be8fe6c757ed04142ab979
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5120d4e7bc38b16858648c29687da41fcc92443461be8fe6c757ed04142ab979>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1e [Aksion ne Korçe, 3 te rinj arrestohen duke trahkuar 6 kg droge me makine! Ja çfare u sekuestrua tjetër gjate kontrollit Pas Meta-s, edhe Snapchat paraajmeron kuhzim fundit](#)

Bashkim Ahmeti hap ekspozitën e tij të parë pas shumë kohësh



17 Shtator 2026, 17:35 Kulturë TEMA



Piktori Bashkim Ahmeti rikthehet me ekspozitën e tij pas shumë kohësh në Tiranë.

“Wanderlust” – “Piktura si Gjeografi e Kujtesës” sjell në mjediset e Galeria Gocat tek Piramida punimet e viteve të fundit të piktorit. Një ndërthurje mes natyrës shumëngjyrëshe dhe peisazheve simbolikë.

“Natyra e Shqipërisë dhe histori personale, të vjetra ato shpeshherë duket sikur unë pikturoj mite dhe legjenda, por marr shkaks nga histori të vjetra për të kuptuar substancën e historisë tonë. Do të veçoja këtë pikturën që e quaj Gjon Gjoj, një histori e dëgjuar në fëmijëri, që motra kërkonte vëllanë. Unë e pikturova duke fluturuar. Për të krijuar një marrëdhënie personazhesh”, tha piktori Bashkim Ahmeti.

Veprat ndërthuren gjithashtu me elementë të historisë dhe trashëgimisë kulturore që lidhen me identitetin shqiptar.

“Arti im ka një frymë romantike në kuptimin që dëshiroj të pikturoj vënde të largëta të kujtesës sime dhe asaj kolektive dhe personazhe pak romantikë të ngjarjeve. Rrobat edhe veshjet, kam insistuar të silueta e burrit, gruas, fustanellës. Polifonia vjen vetvetiu, po shkove të një siluete e një burri me plis e gunë të kujton polifoninë. Silutetat e karaktereve që unë pikturoj”, tha Ahmeti.

Gjirokastra, vendlindja e tij mbetet muza frymëzuese dhe pjesë e pandashme e imagjinatës së piktorit Bashkim Ahmeti.

“Janë mbresat e mi të parë të fëmijërisë aty kam filluar të pikturoj. Në këtë ekspozitë është një tablo e madhe që quhet “Dimër në Gjirokastër” dhe është një tablo monumentale dhe me kuptime simbolike”, tha Ahmeti.

E konceptuar si meditim mbi lëvizjen, ekspozita do të qëndrojë e hapur deri në 18 tetor, ndërsa ka ngjallur interes, pasi i fton vizitorët jo vetëm të sodisin pikturat por të futen në botën e zbulimit të artistit. A.K./Tema



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut/ Kushi: Kujtimi i viktimave është një përgjegjësi morale](#)

09:27 Kulturë

Promovohet novela e Fate Velajt në Pogradec

17:11 Kulturë

[Kufiri Shqipëri–Kosovë: nga represioni dhe ndarja, te arkivat, dija dhe bashkëpunimi akademik](#)

16:34 Kulturë

[Të premten organizohet një forum i veçantë në ambientet e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit](#)

16:26 Kulturë , 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.